



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.687/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Rahman Bibuljica gazetar i radio Hayat me seli në Vitomiric , paraqitur kundrejt njërit prej udhëheqësve të subjektit politik VAKAT, Rustem Nurkoviq, për shkak të sjelljeve të dhunshme dhe agresive, të demonstruara gjatë tubimit parazgjedhor të këtij koalicioni politik, në seancën e panelit të mbajtur me 28.12.2010, mori këtë:

### **VENDIM**

**HIDHET** poshtë si e pasafatshme, ankesa e gazetarit të radio Hayatit, Rahman Bibuljica

### **ARSYETIMI**

Më datën 23.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga gazetari i radio Hayatit Rahman Bibuljica në të cilën theksohet se “me datën 09.12.2010 ditën e Enjte, gazetari Bibuljica, është ndaluar në mënyrë të dhunshme nga Rustem Nurkoviqi (udhëheqës i VAKAT), me qëllim që radio Hayat të mos jete prezent dhe si rrjedhim të mos përcjelli tek publiku tubimin parazgjedhor të koalicionit VAKAT të mbajtur me datën 09.12.2010, ora 13:00, në shtëpinë e kulturës, Vitomiric”. Parashtruesi i ankesës thekson me tej se Nurkoviqi “në hyrjen e derës së shtëpisë së kulturës, ka dale përpara tij dhe nuk e ka lejuar të hyje brenda, si dhe i është drejtuar me fjale fyese duke e thirrur ‘huligan faqezi’, me pas e ka kërcënuar se ‘djelmohat e tij’ do ta nxjerrin jashtë me dhunë”. Parashtruesi i ankesës kërkon që të ndërmerren masat e parapara ligjore. Se bashku me ankesën parashtruesi ka bashkangjitur kopjen e lejes së punës dhe kopjen e letërnjoftimit.

**Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 4, parasheh si vijon:**

*Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda shtatëdhjetedy (72) orë.*

PZAP gjeti se:

**-ankesa është e pasafatshme**

PZAP-i vlerëson se ankesa është e pasafatshme për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Në rastin konkret parashtruesi pretendon se shkelja ka ndodhur me 09.12.2010, ndërsa PZAP e ka pranuar ankesën me 23.12.2010, çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë ligjor prej 72 orësh, në bazë të së cilit palët e interesuara mund të parashtrojnë ankesa që nuk janë të lidhura me numërimin dhe votimin. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 687/2010 më datën 28.12.2010

**Kryesuesi i Panelit**

**Muhamet Rexha**

